

Pasojat e procesit buxhetor

Besiana Xharra | 13-11-2011 12:10 CET

Dështimet në investimet e ndryshme që shkojnë në interes të qytetarëve të Kosovës, vazhdojnë të përcjellin komunat e Kosovës, si pasojë e proceseve jo të mira në ndarjen e buxhetit nga niveli i lartë tek ai lokal.

Duke filluar nga ndarja e granteve që çdo fund vit bën Qeveria për komunat, me ç'rast vazhdon t'u japë prioritet atyre që qeverisen nga partia në pushtet, siç është parë edhe në Projektbuxhetin për vitin 2012, i miratuar ditë më parë nga Qeveria e Kosovës, krerët e komunave ballafaqohen edhe me shkurtime të buxhetit edhe me probleme tjera siç është pamundësia për të vetëqeverisur me mjetet e tyre.

Pika kyç e problemit fillon në Ministrinë e Financave (MF), bën të ditur për "Zëri", Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK).

Ndonëse me Ligjin mbi Financat Lokale, komunat planifikojnë buxhetet e tyre për vitin e ardhshëm, për të cilin zhvillojnë edhe debate publike, e më pastaj atë projektbuxhet e dorëzojnë në MF, kjo e fundit në të shumtën e rasteve i shkurton ato e më pas i dorëzon në Kuvendin e Kosovës për miratim, tregon Ibrahim.

"Është vërejtur tendencë e madhe e zvogëlimit të buxheteve komunale në mallra dhe shërbime. E kjo është për të ardhur keq sepse çdo investim që bëjnë komunat duhet edhe mirëmbajtje", thotë ai.

Sipas një analize të bërë nga drejtorët komunalë për buxhetin e vitit 2012, është vërejtur zvogëlim i grantit për arsim për rreth 3 milionë euro në nivel të Kosovës.

Si ilustrim, ata kanë marrë shembull Komunën e Pejës, e cila pas dhënies së pagave për personelin e arsimit do të ketë në dispozicion vetëm rreth 200 mijë euro për mallra dhe shërbime për 38 institucione shkollore, që ka në menaxhim, mjete këto që pamundësojnë një menaxhim të mirë.

Kryetari i Komunës së Pejës, Ali Berisha, thotë se bazuar në të dhënat që ai ka, buxheti i ndarë për këtë komunë, në të gjithë sektorët është shumë larg nevojave të qytetarëve të saj.

"Bazuar në shumën që kemi, ne jemi komuna e 6 me renditje që kemi marrë grante nga Qeveria, ndërsa sipas të hyrave që kjo komunë jep për buxhetin e Qeverisë jemi e 2-ta në nivel të vendit. Kjo tregon se ne jemi të hendikepuar në këtë aspekt, me ç'rast shumë projekte të planifikuara po dëmtohen", u shpreh ai.

Derisa Komuna e Prizrenit, ka buxhetin 31 milionë euro, Peja e Gjakova së bashku kanë 36 milionë euro, të bën të kuptosh më së miri se Qeveria vazhdon t'u japë prioritet komunave që i qeveris Partia Demokratike e Kosovës (PDK), tha në anën tjetër, kryetari i Komunës Gjakovës, Pal Lekaj.

Megjithëse fjalë të mira nuk thonë as udhëheqësit e komunave të udhëhequra nga partia në pushtet (PDK), sidomos në aspektin e investimeve kapitale, i cili sipas Qemajl Mustafës, kryetar i Gjilanit, ka shumë paqartësi.

“Paraprakisht nuk na është thënë prej ndonjë Ministrie të caktuar që të dorëzojmë projektet në mënyrë që më pas të konkurrojmë me projekte e të ndahen mjetet sipas nevojave. E kjo po ndodh prej se është themeluar buxheti i Kosovës”, u shpreh Mustafa, i cili ndër tjera u ankua për mënyrën e dirigjimit të këtyre mjeteve, duke kërkuar që komunat të shkarkohen nga menaxhimi i Qeverisë dhe të menaxhojnë vetë me mjetet e tyre.

Lidhur me këtë, Sazan Ibrahim, tregon se në Republikën e Kosovës ende kemi situatën kur Ministrinë e Linjës bëhen donatorë ndaj komunave.

“Në vend që paratë e dedikuara për komunat t’u jepen direkt atyre për menaxhim menjëhërë pas aprovimit të buxhetit, ndodh e kundërta, ku ministrinë e ndryshme bëhen donatorë të tyre, duke manipuluar me to, ku ndaj disa komunave sillen si nëne e ndaj disa si njerke”, u shpreh Ibrahim, duke shtuar se këto dhe shumë elemente tjera tregojnë centralizimin e përgjegjësi, të cilat përgjegjësi iu kanë dhënë komunave me Ligjin mbi financat lokale.

Derisa me probleme të tilla po ballafaqohen komunat tash sa vite, hiq më mirë nuk janë edhe komunat e reja të Kosovës, të krijuara apo të zgjeruara si pjesë e procesit të decentralizimit.

Komuna e Novobërdës është zgjeruar për 120 për qind, pra nga 92 km² sa ka pasur kjo komunë, tani ka 112 km², me një buxhet vjetor me vetëm 2.2 milionë euro.

Ndonëse Qeveria pati premtuar se me zgjerim kjo komunë do të financohet më shumë, kjo nuk ka ndodhur, tregon kryetari i kësaj komune, Bajrush Ymeri. Si shembull ai mori një rast. “Vitin e kaluar kryeministri i Kosovës vendosi të ndajë një grant qeveritar shtesë prej 8 milionë eurosh për komunat e reja dhe komunën e zgjeruar të Novobërdës.

Kështu ndau nga një milion euro si për një komunë me vetëm 20 km² si për komunën e Novobërdës me 204 km², duke na diskriminuar”.

Ai tregon se si Ministria e Financave nuk ka miratuar kërkesën e kësaj komune për rritje të buxhetit, në vlerë prej vetëm 340 mijë euro.

Si përfundim Ministria e Financave në nivelin e Qeverisë, po dëmton dhe po punon në kundërshtim me vetë Ligjin mbi financat lokale, thotë Sazan Ibrahim nga AKK, duke kërkuar sa më parë ndryshimin e kësaj qasjeje.

Nuk shkurtojmë buxhetet komunale

Përkundër fakteve dhe argumenteve të paraqitura nga krerët komunalë, zyrtarë nga Ministria e Financave nuk e pranojnë se bëjnë shkurtime apo diskriminime në proceset buxhetore.

“Buxheti i komunave nuk reduktohet apo ndryshohet nga Qeveria, por në rastin e rritjes së pagave me vendim të qeverisë rritet për shumat e kostove përkatëse”, thotë këshilltari i misnitrit, Menderes Ibra.

Sa i përket çështjes se prioritet po u jepet komunave të udhëhequra nga PDK-ja, Ministria e Financave konsideron se kjo nuk qëndron, pasi që vetë fakti i ekzistimit të një procedure të tillë të procesit buxhetor e përjashton këtë mundësi, shtoi ai.